



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Fehmi Zena, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 03.03.2023 VI-020-191
Zyrtaret përgjegjës:	Gëzim Sahiti, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Glllogocit	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Plani i veprimit për transparencë në Komunën e Glllogocit 2023-2027
I miratuar më datë: 23.02.2023
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 27.02.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 23.02.2023, ka miratuar Planin e veprimit për transparencë në Komunën e Glllogocit 2023-2027 i nxjerre nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit është bazuar me nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2020 për Transparencën në Komuna, Rregulloren (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve komunale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe Ligjin Nr. 06/l-081 për qasje në dokumente publike, konstaton se: Plani i Veprimit për Transparencë nga komuna e Glllogocit, është në pajtueshmëri me dispozitat ligjore për transparencë.

Plani i veprimit për transparencë në Komunën e Glllogocit 2023-2027 është miratuar në mbledhjen e Kuvendit me datë 23.02.2023, me 22 vota për dhe 4 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit të Pushtetit Lokal

Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Ramiz Lladrovci, gradonačelnik opštine Glogovac Milaim Hajdari, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elber Krasniqi, ministar MALS-a Fehmi Zena, zamenik generalnog sekretara MALS-a	
Od:	Besim Myrtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština	Dana, 03.03.2023. Br. VI-020-191
Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:	Gëzim Sahiti, zamenik rukovodioca Odseka za monitorisanje opština	
Službenik-ca za izradu prave procene:	Leonora Bajrami, službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Glogovac	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,

Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opština, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju akata opština, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi sledeći opštinski akt:

Akcioni plan za transparentnost u opštini Glogovac za period 2023-2027.

Usvojena dana, 23.02.2023.

Podnošena na razmatranje u MALS-u dana, 27.02.2023.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u proceduralnom aspektu u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Glogovac, na sednici održanoj dana, 23.02.2023.godine, usvojila Akcioni plan za transparentnost u opštini Glogovac za period 2023-2027.godine, doneta od strane Skupštine opštine Glogovac.

MALS, konstatuje da je odluka koju je donela Skupština opštine Glogovac zasnovana na članu 12. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, Administrativnom uputstvu br. 03/2020 o transparentnosti u opštinama, Uredbi (MALS) br. 02/2021 o proceduri za izradu i objavljivanje opštinskih akata, Administrativnom uputstvu (MALS) br. 06/2018 o minimalnim standardima za javne konsultacije u opštinama, kao i na Zakonu br. 06/1-081 o pristup javnim dokumentima, navodi se da: Akcioni plan za transparentnost opštine Glogovac je u skladu sa zakonskim odredbama za transparentnost.

Akcioni plan za transparentnost u opštini Glogovac za period 2023-2027.godinu, usvojena je na sednici Skupštine opštine dana, 23.02.2023. godine, sa 22 glasa "za" i 4 "uzdržana.

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit Gillogoc
Kuvendi i Komunës

02.Nr.030/01-8764 dt.23.02.2023

KOMUNA E DRENASIT - KOMUNITETI MUNICIPALITY OF DRENAS - COMMUNITY		
Shërbimi i Administrimit të Përgjithshëm Lokal Municipal General Administration		
Dati Datum Date	22.02.2023	
Emri i organizatës Organization	Emri i llogaritë Account	Shërbimi Service
-11- 020-131		



Transparenca

KOMUNA E DRENASIT

Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit
2023-2027

Shkurt 2023

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

Plani i veprimit për transparencë komunale ka për qëllim t'i ofrojnë publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës, duke përfshirë informim të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikimin e të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritje të mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Udhëzimi Administrativ Nr.2020/03 për Transparencë në Komuna përcakton obligimin që Komunitat të hartojnë planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë. Ky plan, kërkon nga komuna të ndërmarrë veprime konkrete në promovimin dhe ofrimin e transparencës së plotë tek : mbledhjet e Kuvendit të Komunës; mbledhjet e komiteteve ; takimet publike; takimet konsultative për projekte; transparencën në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit të komunës; qasje të shpejtë në shërbime elektronike (me sa më pak klikime) dhe fizike; procedura transparente në aktivitetet e prokurimit; procedura transparente të punësimit; përditësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve ditore në faqe zyrtare të komunës; përfshirjen aktive të qytetarëve në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe akteve tjera që i konsideron komuna të domosdoshme për konsultim.

Plani i Veprimit për Transparencë mundëson:

- Prezantimi i planifikimit të punëve të organeve të vetëqeverisjes lokale me sistemet e informacionit në mënyrë që puna e organeve të administratës gjatë zhvillimit të politikave të vërtetohen dhe legjitimohen;
- Përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme në hartimin dhe zbatimin e politikave në nivel lokal;
- Rezultatet e punës së komunave të jenë të matshme, cilësore dhe në funksion të interesave të përgjithshme të qytetarëve.

Plani i veprimit për transparencë në mënyrë specifike do të kontribuojë që:

- Komuna të identifikoj me kohë prioritetet për të cilat kërkohet informimi, si dhe përfshirja e qytetarëve apo grupeve të interesit në proces të hartimit të politikave dhe akteve të përgjithshme;
- Të identifikoj metodat, mjetet dhe teknikat për konsultimin e qytetarëve dhe përfshirjen e tyre në procese;
- T'i evitoj praktikatat e zhvillimit të dokumenteve dhe politikave pa respektim të procedurave ligjore lidhur me informimin dhe konsultimin e qytetarëve si dhe të evitoj praktikatat e zhvillimit të dokumenteve dhe politikave me kosto të papërballueshme;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm transparent dhe llogaridhënës, duke inkurajuar bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe mbikëqyrjen e politikave;

- Mbajtjen e një sistemi dhe përditësim i vazhdueshëm me të dhënat e të gjitha palëve të interesit për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet ligjore;
- Ndikimin në sjelljet e punonjësve komunal në mënyrë që veprimet e ndërmarra të demonstrojnë ligjshmëri dhe integritet;

Zbatimi i Planit të veprimit për transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës dhe do të rishikohet periodikisht në përputhje me aktivitetet e komunës. Planit do të përmbledh në mënyrë të qartë transparencën e organeve komunale, publikimin e akteve nënligjore, rregulloret komunale, dokumentet strategjike, vendimet e kryetarit, njoftimet për aktivitetet e komunës (ekzekutivit dhe kuvendit të komunës), takimet publike, planifikimin dhe shpenzimet buxhetore të komunës, prokurimin publik, zbatimin e standardeve të konsultimit publik, qasjen në dokumentet publike etj.

Transparenca si parim i qeverisjes së mirë

Në një sistem demokratik funksional, informimi dhe përfshirja duhet të jenë segment vital i administrimit publik. Transparenca është komponentë kryesore e qeverisjes demokratike, e cila kërkon një hallkë të gjerë të veprimeve institucionale, si në procesin e hartimit të politikave ashtu edhe në fazën e zbatimit dhe raportimit. Rëndësia e transparencës ndikon në aspekte të shumta duke përfshirë qëndrueshmërinë ekonomike, financiare, qeverisjen e mirë, si dhe në sistemin e përgjithshëm të administratës shtetërore. Parimi i publicitetit dhe transparencës supozojnë se çdo kush ka të drejtë të dijë arsyet e nxjerrjes së një vendimi të caktuar apo veprimi të administratës. Përmes këtij parimi mundësohet hapja e administratës para shoqërisë, informimi për punën e saj mund të bëhet në mënyrë të ndryshme dhe në vëllim të ndryshëm, parim që mund të kufizohet vetëm në rastet e caktuara në legjislacionin e secilit vend. Të qenurit i hapur dhe transparent janë gjithashtu instrumente të nevojshme për shtetin e së drejtës, barazinë para ligjit, dhe përgjegjshmërinë. Si rregull i përgjithshëm, sjellja e administratës publike duhet të jetë transparente dhe e hapur, megjithëse të dhënat personale nuk duhet t'i lejohen palëve të treta. Transparenca është një nga çështjet më me peshë në procesin e demokratizimit të shteteve dhe qeverisjes së mirë. Këtë e mundësojnë mekanizmat dhe iniciativat e qeverisjes së hapur, të cilat bëjnë që përfitimet e transparencës të jenë në shumë aspekte, përfshirë: qeverisje më e mirë, vendimmarrje më cilësore, besim më të madh publik, ulje të korrupsionit dhe shërbime publike më efektive. Transparenca përfshin rregullat mbi të drejtat e krijimit, ruajtjes, qasjes dhe përpunimit të informacionit, të cilat mund të shfrytëzohen gjatë proceseve të vendimmarrjes, por edhe për nevoja të informimit të përgjithshëm. Për më tepër, në kuptim më të gjerë transparenca nuk është vetëm informim, por përfshinë një varg procesesh dhe veprimesh të bazuara në: informacion, komunikim, pjesëmarrje, angazhim, ndërtim të konsensusit për zgjidhjen e problemeve, raportim dhe llogaridhënie.

Korniza ligjore për transparencë

Në pajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës janë miratuar një numër i madh i ligjeve dhe akteve nënligjore, që rregullojnë fushën e transparencës. Ligji për Vetëqeverisje Lokale është aprovuar në vitin 2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe bën pjesë në grupin e ligjeve me karakter vital për shtetin. Përmbajtja e këtij ligji reflekton parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, duke paraparë mekanizma të veçantë të informimit, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të drejtave të qytetarëve, e në veçanti të drejtave të komuniteteve joshumicë. Me këtë ligj është përcaktuar që kuvendi i komunës të miratojë rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislativë, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës. Përveç kësaj, me anë të një numri të konsiderueshëm të akteve nënligjore janë definuar edhe procedurat e zbatimit të instituteve të shumta juridike për transparencë, janë përcaktuar zyrtarët përgjegjës, format dhe teknikat për transparencë, si dhe afatet procedurale. Në përgjithësi, kuadri juridik normon obligime për organet e administratës shtetërore në fushën e transparencës, ndërsa në veçanti për organet e pushtetit, përmes akteve si në vijim:

- Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;
 - Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;
 - Ligji Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
 - Ligji Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë;
 - Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
 - Ligji Nr.04/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 03/L-211;
 - Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve;
 - Ligji Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës
-
- Rregullore (QRK) Nr. 27/2018 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun;
 - Rregullore Nr. 04./2012 për Evidencën Zyrtare të Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike;
 - Rregullore (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik;
 - Rregullore Nr. 02/2012/MF për Tarifatat në qasje në dokumente publike;
 - Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencën në Komuna;
 - Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;
 - Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 01/2019 për Monitorimin e Kuvendeve të Komunave Përmes Pajisjeve të Teknologjisë Informative “Teleprezencave”;

- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2021 për Funksionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në Komunë;
- Udhëzim Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike;
- Rregullore (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës;
- Rregullore Nr.01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit të Përfundimit të Performancës Komunale;
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna;

Aktet komunale:

- Statuti i komunës;
- Rregullore komunale për transparencë;
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që ndërlidhen me fushën e transparencës.

Qasja strategjike për fuqizimin e transparencës

Në nivel qendror janë zhvilluar një numër strategjish të cilat parashohin objektiva me synim reformën e administratës shtetërore. Ndër strategjitë kryesore në fushën e qeverisjes së mirë, transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në institucionet e administratës janë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim, 2022-2030;
- Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026;
- Strategjia për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023;
- Agjenda për Reforma Evropiane;
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKMSA)
- Strategjitë e tjera sektoriale.

Dokument specifik me ndikim në transparencën komunale është Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Kjo strategji ka 5 objektiva kryesore përmes së cilave përcaktohen caqet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të pushtetit lokal në Kosovë. Në objektin e tretë të saj, strategjia parasheh *forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive*. Bazuar në problemet e identifikuar, në planin e veprimit të kësaj strategjie parashihen aktivitetet konkrete të masave, që përfshijnë zhvillimin e politikave efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve, respektivisht:

- Politikat lokale për nxitjen e aktivizimit qytetar;
- Politikat për nxitjen e punës vullnetare të studentëve dhe nxënësve;
- Politikat për funksionalizimin e qendrave rinore nëpër fshatra;
- Politikat për funksionalizimin e këshillave të fshatrave;
- Politikat për përfshirjen dhe angazhimin e pensionistëve në jetën publike;
- Politikat për angazhimin e personave me aftësi të kufizuara;
- Politikat për nxitjen e pjesëmarrjes së grave si dhe kategorive sociale të pambrojtura;
- Politikat lokale për trajtimin e fëmijëve të rrugës;

- Politikat lokale për krijimin e rrjeteve sociale, ekonomike, rinore, sportive dhe kulturore.¹ Strategjia parasheh po ashtu masa konkrete në krijimin e platformave që fuqizojnë transparencën, e në veçanti përmes qeverisjes elektronike. Qeveria elektronike sigurisht që lehtëson komunikimin në mes të grupeve të interesit me autoritetet publike, derisa ajo forcon administratën përmes: kursimit të kohës në ofrimin e shërbimeve, uljes së kostos operative, rritjes së efikasitetit, ruajtjes së memories institucionale dhe rritjes së llogaridhënies.

Andaj, masat e tilla të ndërhyrjes janë të rëndësishme, për faktin se përmirësojnë komunikimin me qytetarë, krijojnë hapësirë për politikbërje të qëndrueshme, zbatim efikas të tyre, si dhe plotësojnë obligimet e Kosovës në raport me kriteret e kërkuara nga Bashkimi Evropian.

Mekanizmat ligjorë për pjesëmarrje dhe zbatim të parimit të transparencës

Qeverisja lokale në Kosovë promovon fuqishëm parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje. Mënyra e parë dhe më e thjeshtë në të cilën transparenca mund të ndihmojë në ofrimin e paanësisë është duke lejuar publikun të luajë një rol të rëndësishëm në garantimin që rregullat të zbatohen në mënyrë të drejtë dhe korrekte. Qytetarët nuk mund të jenë askund më afër me shtetin se përmes organeve të pushtetit lokal. Komunitat janë adresa më e afërt për të kërkuar që shërbimet dhe resurset shpërndahen në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe në pajtim me nevojat sistematike të tyre.

Numri më i madh i taksave dhe tatimeve që mbledhen nga shteti, u shpërndahen komunave për ushtrimin e kompetencave ligjore. Taksat për të cilat qytetarët paguajnë në baza periodike janë burime vetanake të komunave, të cilat shpenzohen për shërbimet e ofruara. Planifikimi i shpenzimit të tyre bëhet me anë të buxhetit komunal, që është dokument kryesor vjetor që mbledh të gjitha projektet investive me interes publik. Gjatë përgatitjes së buxhetit, komunitet ligjërisht obligohen të mbajnë konsultime me qytetarët, bizneset, grupet e interesit dhe shoqërinë civile. Prandaj, qeverisja e mirë komunale do të zinte vend vetëm nëse planifikimi i mjeteve buxhetore, politikave të tjera, shpenzimet e tyre dhe mënyra e shpërndarjes së investimeve publike do të mbështetej në opinionin e qytetarëve, përmes formave të shumta të përfshirjes direkte të tyre.

Në mënyrë që transparenca të jetë pjesë përbërëse e politik bërjes në nivel lokal, Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar një numër të shumtë të instrumenteve juridike për pjesëmarrje të qytetarëve në jetën publike ku bëjnë pjesë:

- Takimet publike gjithëpërfshirëse me qytetarë;
- Konsultimet për projekt-aktet dhe dokumente të politikave;
- Informimi dhe konsultimi përmes e-qeverisjes;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile;
- E drejta për qasje në dokumentet publike.
- Komitetet konsultative;
- Iniciativat qytetare, peticionet dhe referendumat lokale;

¹ Qeveria e Republikës së Kosovës: "Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026", Prishtinë, 2016, fq. 32

Të gjitha këto forma kanë bazën e tyre juridike, procedurale, mjetet dhe format e zbatimit të tyre. Efekti i tyre në përmirësimin e qeverisjes lokale vërehet përmes rritjes së transparencës, krijimit të qytetarisë aktive dhe forcimit të dialogut social. Edhe pse të shumta, aplikimi i tyre ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, për çka tregojnë statistikatat e shumta të dala nga raportet e monitorimit të institucioneve të ndryshme publike dhe jopublike. Gjithashtu, jo të gjitha janë të zbatueshme për shkaqe juridike, por edhe praktike.

Objektivat e Planit të Veprimit për transparencë

Objekti kryesor i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale është *“të siguroj qeverisje të hapur për qytetarë, gjithëpërfshirje në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të politikave, si dhe qeverisje transparente dhe llogaridhënëse”*.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një kornize të qartë të planifikimit të organizuar, ku përcaktohen rolet e të gjithë pjesëmarrësve përgjegjës për transparencë komunale.
- Fuqizimi i mekanizmave lokal të demokracisë direkte, për të krijuar një publik të interesuar për çështje publike;
- Avancimi i mekanizmave të informimit në mënyrë që qytetarët të dëgjojnë dhe të inkurajohen për të qenë aktiv në proceset vendimmarrëse.
- Krijimi i një sistemi efektiv qeverisës, në të cilin parim kryesor i projektimit të politikave është baza e informacionit.
- Ndërtimi i partneritetit të mirëfilltë me shoqërinë civile, në të gjitha fazat e menaxhimit të organeve komunale.

Fazat e zhvillimit të Planit të Veprimit për Transparencë Komunale

Zhvillimi i Planit të Veprimit për Transparencë duhet të kalojë në disa faza si në vijim:

- 1) **Faza Paraprake** – Kryetari i komunës themelon grupin e punës. Përbërja e grupit punës duhet të jetë shumësektoriale dhe të udhëhiqet nga Zyra për Komunikim Publik në bashkëpunim me zyrën ligjore të komunës. Procedurat e hartimit zhvillohen në pajtim me rregullat në fuqi për procedurat e hartimit të akteve komunale.
- 2) **Faza e vlerësimit të prioriteteve** – gjatë kësaj faze, kryesuesi së bashku me grupin punës analizon dokumentacionet e mbledhura (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së komunës; dokumentet strategjike të komunës mbi bazën e të cilave priten të zhvillohen aktet juridike të komunës, planet komunale, dokumentet e tjera të politikave për të cilat duhet të zhvillohen konsultime publike dhe të sigurohet prania e qytetarëve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale dhe planeve

afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjate, duhet të përcaktohen prioritetet dhe të bëhet renditja e veprimeve për secilin aktivitet.

- 3) *Faza e përcaktimit të aktiviteteve dhe propozimit të masave* – kjo fazë përfshin kategorizimin e prioriteteve sipas periudhave të zhvillimit, renditjen e aktiviteteve, metodave dhe mjeteve të veprimit, afatet kohore, organet/zyrtarët përgjegjës, koston financiare.
- 4) *Faza e mbikëqyrjes dhe raportimit të planit të veprimit për transparencë* - përfshin mbikëqytjen, regjistrimin dhe raportimin e rregullt të aktiviteteve që zhvillohen sipas Planit të veprimit për transparencë. Raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirësojnë zbatimin e objektivave të Planit të Transparencës Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e planit vjetor të punës së komunës.

Metodologjia e vlerësimit dhe përcaktimit të aktiviteteve të transparencës

Vlerësimi i aktiviteteve të transparencës do të thotë renditja e veprimeve në Plan sipas prioriteteve, duke mundësuar që komuna të jetë e hapur dhe bashkëpunuese me qytetarë në të tri fazat kyçe të menaxhimit: 1) Planifikim; 2) Zbatim; 3) Raportim.

Prioritetet përcaktohen duke marrë për bazë rëndësinë e proceseve, përkatësisht: Natyrës së veprimtarisë që do të ndërmerret nga organi përkatës i komunës; Llojeve të dokumenteve të politikave për të cilat kërkohet përfshirja e qytetarëve; Fushëveprimit të akteve juridike të planifikuara për hartim; Ndikimit të tyre ekonomik dhe social; Peshës financiare të politikës së propozuar; Periudhës kohore të veprimit; Shtirjes gjeografike; etj.

Pas përcaktimit të aktiviteteve grupi punues cakton prioritetet dhe metodat e veprimit të cilat duhet të jenë pjesë përbërëse e planit të veprimit, të cilat janë të ndryshme varësisht se për cilën fazë të menaxhimit bëhet fjalë.

Mbikëqyrja e zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë

Zbatimi i Planit të Veprimit për Transparencë do të mbikëqyret në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me ndryshimet ligjore, institucionale, procedurale dhe të personelit, në varësi të ndikimeve nga mjedisi i jashtëm apo i brendshëm i Komunës.

Mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatim është e rëndësishme për t'u siguruar se masat e parapara janë efektive dhe ndikojnë në cilësinë e politik-bërjes, si parakusht i ligjshmërisë së procesit vendimmarrës. Gjithashtu, mbikëqyrja duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë sjellë vendimmarrje cilësore, efikase dhe efektive, me kosto reale dhe të përballueshme.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Me qëllimi të sigurimit të zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë, krijohet mekanizmi për mbikëqyrje dhe raportimin e këtij plani, si në vijim:

Grupi punues - emërohet me vendim të kryetarit të komunës dhe është përgjegjës për:

- Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale;
- Grupi është njëherësh siguruës i zbatimit të Planit dhe garanton që në baza periodike Planin Vjetor i Punës së Komunës të ndërlihet me aktivitetet dhe masat e përcaktuara në Planin Vjetor të Veprimit për Transparencë;
- Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së komunës;
- Propozon masa të nevojshme për zbatimin e plotë të masave të propozuara në Planin e Veprimit për Transparencë;
- Mbikëqyrë zbatimin e masave për përmirësimin e transparencës;
- Raporton tek kryetari për zbatimin e Planit të Veprimit për Transparencë;

Plani i Veprimt për Transparencë në Komunën e Drenasit

Objektivat	Aktivitetet	Treguesit e matjes	Afati kohor	Njësia/personi përgjegjës	Mënyra e njoftimit / zbatimit	Dokumentet referuese	Kolonë raportim
Transparenca e kuvendeve të komunave							
Informimi i rregullt i qytetarëve dhe grupeve të interesit për aktivitetet dhe vendimet e Kuvendit të komunës dhe komiteteteve	Publikimi i njoftimeve, sigurimi i materialeve të nevojshme, hapësirës për pjesëmarrjen publikut dhe përfaqësuesit e mediave të shkruara/elektronike në takimet e Kuvendit të komunës dhe komiteteteve.	1) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare për mbledhje të kuvendit në ueb faqe zyrtare të komunës ; 2) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare për mbledhje të komiteteteve në ueb faqe zyrtare të komunës.	1) Njoftimi shtatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta Kuvendit; 2) Njoftimi 3 ditë pune para mbledhjes së jashtëzakonshme; 3) Thirrja brenda ditës për mbledhje urgjente.	Kryesuesi i kuvendit të Komunës; Kryesuesi i Komitetit përkatës; Sekretaria e Kuvendit; Zyra për informim.	Përmes ueb-faqes zyrtare; Shpalljeve publike; Formave të tjera të informimit.	- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; - Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; Rregullore e punës së Kuvendit. - Statuti i Komunës; - Rregulloja komunale për transparencë.	
	Transmetimi në kohë reale i mbledhjeve të kuvendit të komunës.	Numri i mbledhjeve të kuvendit të transmetuara drejtpërdrejtë.	Në vazhdimësi	Sekretaria e kuvendit; Zyrtari i IT-së; Zyra e informimit.	Përmes ueb-faqes zyrtare; Rrjeteve sociale; Youtube; Mediave lokale.	- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; - Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; - Statuti i Komunës.	
	Publikimi i akteve të kuvendit të komunës	1) Numri i akteve të aprovuara; 2) Numri i akteve të publikuara në gjuhët zyrtare	Pas afatit 15 ditor të shqyrtimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për qeverisje lokale	Kryesuesi i kuvendit; Sekretaria e kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës; Gazeta Zyrtare e Kosovës.	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Rregullore (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës;	

Publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës.	Plani i publikuar në ueb-faqen zyrtare të komunës.	Fillimi i muajit Janar	Kryesuesi i kuvendit; Sekretaria e kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës.	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna.
Publikimi i raportit të punës së kuvendit të komunës.	Raporti vjetor i publikuar në ueb-faqen zyrtare të komunës	Deri më 31 janar për vitin paraprak	Kryesuesi i kuvendit; Sekretaria e Kuvendit Zyra për informim;	Ueb-faqja e komunës; Platforma të tjera sociale.	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna
Publikimi i profileve të anëtarëve të kuvendëve të komunave.	Biografi të anëtarëve të kuvendit dhe të dhënat kontaktuese të publikuara;	Me rastin e marrjes së mandatit;	Kryesuesi i kuvendit të komunës; Anëtarët e kuvendit të komunës; Sekretaria e Kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike;
Publikimi i të dhënave për përbërjen e komiteteve të kuvendit dhe funksioneve të tyre;	1) Të dhënat e përfaqësuesve në komitete të publikuara; 2) vendimet për themelimin e komiteve të publikuara; 3)Përgjegjësitë e komiteteve të përshkruara në ueb-faqe.	Sipas kohës së themelimit dhe funksionalizimit;	Kryesuesi i kuvendit të komunës; Kryesuesi i komitetit përkatës; Sekretaria e Kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; Udhëzim Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike.

	Themelimi i komiteve konsultative.	Numri i komiteve konsultative të themeluara; Numri i kërkesave të parashtruara për themelimin e komiteve.	Initiativë e kuvendit të komunës apo pas parashtrimit të kërkesës / ose me rastin e përfundimit të mandatit të komitetit.	Kuvendi i kuvendit të komunës.		U.A. 01/2016 për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteve konsultative në komuna; U.A. Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteve të përshërime dhe komiteve tjera në komunë.	
Transparenca e Kryetarit të Komunës / Përfshirja e qytetarëve/ Qasja në dokumentet publike / Informimi publik							
Informimi i rregullt i qytetarëve dhe grupeve të interesit për aktivitetet dhe vendimet e kryetarit të komunës	Publikimi i akteve të kryetarit të komunës.	Lista e akteve të aprovuara e publikuar.	Në vazhdimësi.	Zyra për informim; Zyra e Kryetarit.	Ueb-faqja e komunës.	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna.	
	Publikimi i listës së pronave të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për vitin e ardhshëm, pas miratimit në Kuvend të Komunës.	Lista e pronave e planifikuara për dhënie në shfrytëzim, e publikuar.	Deri me 31 dhjetor të vitit paraprak.	Zyra e Kryetarit; Sekretaria e kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës; Gazeta Zyrtare e Kosovës.	Ligji Nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna.	
	Mbajja e se paku dy takimeve publike me qytetare brenda vitit.	2 takime të mbajtura gjatë vitit.	Takimi i parë në gjashtëmuorin e parë të vitit; Takimi i dytë në gjashtëmuorin e dytë të vitit;	Zyra e Kryetarit; Zyra për informim.	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës; Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit; Takime të drejtpërdrejta;	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	

Inkurajimi i qytetarëve për pjesëmarrje në proces të hartimit të politikave dhe dokumenteve në nivel lokal	Numri i takimeve konsultative tjera në kuadër të lagjeve, vendbanimeve dhe lokacioneve tjera.	Numri i takimeve për të cilat është plotësuar kushti i njoftimit 14 ditë dhe gjuhët zyrtare; Numri i takimeve për të cilat kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga publiku janë evidentuar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës, brenda 15 ditëve pas përfundimit të takimit.	Njoftimi i shpallur 14 ditë para takimit në gjuhët zyrtare.	Zyra e Kryetarit; Zyra për informim.	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës; Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit; Takime të drejtpërdrejta.	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna.	
	Shqyrtimi i kërkesave/iniciativave dhe peticioneve të qytetarëve	1) Numri i kërkesave, iniciativave qytetare dhe peticioneve të parashtruara tek Kryetari; 2) Numri i iniciativave kërkesave, iniciativave qytetare dhe peticioneve të shqyrtuara brenda 60 ditësh; 3) Numri i njoftimeve të publikut brenda 15 ditësh për kërkesat, iniciativat qytetare dhe peticionet e parashtruara.	.	Kuvendi i komunës; Kryetari i komunës.		Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	
	Mbajtja e takimeve me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB)	Numri i takimeve me qytetarët për KAB	Para datës 30 Qershor	Komiteti për Politikë dhe Financa; Kryesuesi i Kuvendit; Kryetari i komunës;	Njoftimi përmes ueb-faqes së komunës, apo shpalljeve të tjera; Takime të drejtpërdrejta; Konsultimet me shkrim;	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna	

				Drejtoria për Ekonomi dhe Financa; Drejtoritë tjera.	Konsultimet elektronike; Platforma qeveritare për konsultime publike; Format tjera të përcaktuara në nenin 10 të U.A. për standardet minimale të konsultimit publik;		
Përfshirja e hershme e publikut në procesin e planifikimit të punëve të kryetarit të komunës	Projekt-Plani i ekzekutivitet për vitin e ardhshëm kalendarrik i publikuar për konsultim me qytetarë	Deri në fund të muajit dhjetor	Zyra për informim; Zyra e Kryetarit;	Ueb-faqja e komunës; Platforma Qeveritare për Konsultime Publike; Forma të tjera të vlerësuara nga komuna	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komunë; Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komunë		
Përfshirja e hershme e publikut në procesin e planifikimit të punëve të kuvendit të komunës	Projekt-Plani i kuvendit të komunës për vitin e ardhshëm kalendarrik i publikuar për konsultim me qytetarë	Deri në fund të muajit dhjetor	Kryesuesi i Kuvendit të komunës; Sekretaria e kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës; Platforma Qeveritare për Konsultime Publike; Forma të tjera të vlerësuara nga komuna	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komunë; Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komunë		
Mbajtja e konsultimeve me qytetarë për projektbuxhetin e komunës nga kryetari i komunës	Konsultimet publike për projektbuxhet, të mbajtura nga kryetari i komunës / ekzekutivi	Para datës 1 shtator	Kryetari i komunës; Drejtoria për Ekonomi dhe Financa; Drejtoritë tjera.	Njoftimi përmes ueb- faqes së komunës, apo shpalljeve të tjera; Takime të drejtpërdrejta;	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komunë; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komunë;		

	Mbajtja e konsultimeve me qytetarë për Planin Zhvillimor Komunal, Harta Zonale dhe Planet Rregullative	PZHK, HZ dhe Planet Rregullative të konsultuara me publikun	Në vazhdimësi	Zyra e Kryetarit; Kryesuesi i grupit punues për hartimin e projekt dokumentit; Drejtorja e Planifikimit; Zyra për informim;	Publikimi i procesverbaleve dhe raporteve në Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;	
Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së kryetarit/ekzekutivit	Diskutimi i raportit të kryetarit në kuvendin e komunës	Raportet e paraqitura për diskutim në kuvendin e komunës	Njëherë në gjashtë muaj apo kërkohet që kuvendi i komunës	Kryetari i komunës; Ekzekutivi;	Inkorporimi në rend dite; Diskutimi në kuvend	Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Statuti i Komunës; Rregullojta e Kuvendit.	
	Dorëzimi i raporteve tremujore financiare në kuvendin e komunës dhe publikimi në ueb-faqen zyrtare	1) Raportet e paraqitura për diskutim në kuvendin e komunës; 2) Raportet e publikuara në ueb-faqe	1) Tremujori 4 para datës 31 Janar; 2) Tremujori 1 para datës 30 Prill; 3) Tremujori 2 para datës 31 Korrik; 4) Tremujori 3 para datës 31 Tetor	Kryetari i komunës; Ekzekutivi; Zyra për informim.	Inkorporimi në rend dite; Diskutimi në kuvend; Publikimi në ueb-faqe.	Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna.	
	Publikimi i raportit përfundimtar financiar	Raporti i publikuar	Jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik	Kryetari i komunës; Ekzekutivi; Zyra për informim.	Ueb-faqja zyrtare e komunës	Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	

	Publikimi i listës së subjekteve përfituese nga kategoria e subvencioneve	Lista e përfituesve të subvencioneve, e publikuar;	Pas miratimit të listës nga ana komisionit vlerësues	Zyra e informimit Drejtoria përkatëse.	Ueb-faqja zyrtare e komunës; platformat e tjera sociale	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna; Udhëzimi Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb-faqet e institucioneve publike;	
	Prezantimi, diskutimi në kuvendin e komunës si dhe publikimi i Raportit të Performancës Komunale	Raporti i Performancës Komunale i prezantuar dhe i diskutuar në kuvendin e komunës Raporti i Performancës Komunale i publikuar në ueb faqen e komunës. (pas publikimit në ueb faqen zyrtare të MAPL-së)	Gjatë vitit për vitin paraprak	Kryesuesi i kuvendit të komunës; Sekretaria e Kuvendit; Zyra për informim.	Ueb-faqja e komunës;	Rregullore Nr.01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Skemën e Grantit të Performancës Komunale	
	Diskutimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kuvendin e Komunës	Raporti i inkuorpuar në rend të ditës dhe i diskutuar në KK; Raporti i publikuar në ueb faqen e komunës	Pas publikimit nga ZKA	Kryesuesi i kuvendit; Kryetari i komunës; Zyra për informim.	Inkuorporimi në rend dite; Diskutimi në kuvend; Publikimi në ueb-faqe	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	
	Publikimi i Planit të Prokurimit për vitin fiskal	Plani i prokurimit i publikuar në ueb-faqe	Pas miratimit dhe shpalljes së ligjit vjetor për ndarjet buxhetore	Zyra për prokurim; Zyra e informimit	Ueb-faqja e komunës; E-prokurimi	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	
Sigurimi i transparencës në procedurat e prokurimit publik	Publikimi i Raportit vjetor të zbatimit të Planit për prokurim publik	Raporti i prokurimit i publikuar	Jo më vonë se 31 janar, për vitin paraprak	Zyra për prokurim; Zyra e informimit	Ueb-faqja e komunës	Ligji i Prokurimit Publik; Udhëzimi Administrativ të MAP-it për mirëmbajtjen e faqeve elektronike të institucioneve publike; Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik;	

							Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë	
	Publikimi i gjitha aktiviteteve të prokurimit në ueb-faqen e komunës		Numri i aktiviteteve të prokurimit të publikuara në	Në vazhdimësi	Zyra për prokurim; Zyra e informimit.	Ueb-faqja e komunës; E-prokurimi	Ligji i Prokurimit Publik; Udhëzimi Administrativ të MAP-it për mirëmbajtjen e faqeve elektronike të institucioneve publike; Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë	
	Krijimi i strukturave përgjegjëse komunale për koordinimin dhe zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik		Zyrtari përgjegjës për konsultim publik, i caktuar me vendim të kryetarit		Kryetari i komunës;		Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;	
Ngritja e cilësive të konsultimeve të politikave dhe akteve të komunës përmes zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në nivel lokal	Informimi me kohë për dokumentet, projekt-aktet, mënyrat dhe format e konsultimit, vendin dhe afatet e konsultimit publik Përfshirja e hershme e qytetarëve – komunitetit në procesin e planifikimit të intervenimeve në hapësirat publike dhe projektet me interes për komunitetin lokal.	1. Numri i akteve/dokumenteve për të cilat kërkohet konsultimi publik; 2) Numri i njohimeve të shpallura për konsultime publike; 3) Bashkëngjitja projekt-propozimit, dokumentin konsultues që përmban afatet e konsultimit, memorandumet shpjeguese dhe adresën për pranimin e komenteve	Së paku tetë (8) ditë dhe maksimum katërbëdhjetë (14) ditë.	Zyrtari përgjegjës për konsultim në koordinim me zyrtarin përgjegjës për hartim të projekt-propozimit	Ueb-faqja e komunës; Rrjete sociale; Media lokale etj. Platforma për Konsultime Publike.	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;		

	Pjesënarja e publikut në grupet punuese	Numri i grupeve punuese të themeluara; Numri i grupeve punuese që përfshijnë qytetarët/shoqëritë civile	Me rastin e themelimit të grupeve punuese	Kryetari i komunës; Organi propozues	Njofimi përmes ueb-faqes/ thirrjeve publike/ përfshirjes në aktet themeluese	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë	
	Krijimi i rubrikës së veçantë me të dhënat e procesit të konsultimit publik	Rubrika e krijuar në ueb-faqe; Vegëza/ikona e integruar në ueb-faqe për Platformën e Qeverisë për konsultime publike.		Zyra e Informimit	Në koordinim me MAPL-në dhe Zyren për Qeverisje të Mirë	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;	
	Mbledhja/shqyrtimi i komenteve/propozimeve gjatë procesit të konsultimit publik dhe përgatitja raportit për rezultatet e konsultimit publik	1. Numri i komenteve të parashtruara; 2) Raporti për rezultatet e konsultimit publik i hartuar dhe publikuar.	Së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendariq për projekt propozimin që nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim	Zyrtari përgjegjës për hartim të projekt-propozimit në bashkëpunim me grupin punues dhe zyrtarin përgjegjës për konsultime publike	Publikimi në ueb-faqe i formularit standard për konsultimet publike i; Komentet e pranuarat përmes zyrtarit përgjegjës; Publikimi i dokumentacionit për konsultim në ueb-faqen e komunës dhe platformën qeveritare të konsultimeve publike.	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;	
Garantimi i plotë i të drejtave për qasje në dokumentet publike	Shqyrtimi i rregullt i kërkesave për qasje në dokumente publike	1) Numri i kërkesave të parashtruara nga palët; 2) Numri i kërkesave të shqyrtuara për të cilat palët kanë marrë përgjigje	Shitë (7) ditë nga dita e pranimit të kërkesës nga kërkuesi	Zyra për informim / Zyrtari përgjegjës për qasje në	Pranimi përmes zyrtarit përgjegjës për konsultime publike.	Ligji Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike; Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna;	

	Publikimi i buxhetit vjetor	Plani buxhetor i publikuar në ueb-faqen e komunës	Pas miratimit në kuvendin e komunës	Zyra për informim; Zyra e Kryetarit	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komunë;
	Publikimi i procesverbaleve nga mbledhjet e takimeve të kuvendit të komunës dhe Komiteteve obligative	Procesverbalet e mbledhjeve të kuvendit të komunës të publikuara në ueb-faqen e komunës Procesverbalet e mbledhjeve të komiteteve obligative të publikuara në ueb-faqen e komunës	Pas miratimit në kuvendin e komunës Pas miratimit në mbledhjet pasuese të komiteteve obligative	Kryesuesi i kuvendit; Kryesuesi i komitetit obligativ; Sekretaria e kuvendit; Zyra për informim;	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komunë;
	Publikimi i Strategjive dhe dokumentet tjera të politikave në nivel lokal	Strategjitë dhe dokumentet tjera të politikave në nivel lokal të miratuara publikohen në ueb-faqe	Pas miratimit në kuvendin e komunës	Kryesuesi i kuvendit; Sekretaria e kuvendit; Drejtorja përkatëse; Zyra për informim;	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komunë;
	Publikimi i Planit Zhvillimor Komunal, Hartat Zonale dhe Planet Rregulluese	PZH, HZ dhe PR të publikuara në ueb-faqen e komunës	Pas miratimit në kuvendin e komunës	Kryesuesi i kuvendit; Sekretaria e kuvendit; Drejtorja përkatëse; Zyra për informim;	Ueb-faqja e komunës;	Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komunë;

Përbushja e kritereve të ueb-faqes zyrtare, lehtësimi i marrjes së shërbimeve dhe informimi i rregullt për qytetarë	Publikimi i procedurave në marrjen e shërbimeve të ofuara nga drejtoritë dhe njësitë organizative të komunës	1) Numri i shërbimeve që ofron institucioni për publikun; 2) Numri i procedurave dhe kushteve të përfuturit të tyre dhe afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar të publikuara në gjuhët zyrtare; 3) Lista e shërbimeve administrativ që ofron institucioni për publikun, si: licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku do të përfshihen, e publikuar në gjuhët zyrtare	Në vazhdimësi	Drejtoria e Administratës Zyra për informim	Ueb-faqja e komunës; Qendra për shërbim të qytetarëve	Udhëzimi Administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike; Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë;	
	Ofrimi i shërbimeve elektronike nga Qendra për Shërbim të Qytetarëve	Informimi dhe ofrimi i shërbimeve të hapura online nga Qendra për Shërbim të Qytetarëve. Ofrimi i shërbimeve për qytetarët përmes E- kioskës.	Në vazhdimësi	Drejtori i Administratës / Qendra për Shërbim të Qytetarëve	Qendra për Shërbim të Qytetarëve	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencë; Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 01/2021 për funksionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në komunë	

Komisioni Komunal për hartimin e Planit të Veprimit për Përbushjen e Transparencës Komunale 2023-2027:

Bekim Dobra, kryetar i komisionit,
Altina Mulaj-Hajdini, anëtare,
Avdyll Mziu, anëtar,
Liridona Ajazi-Fejza, anëtare,
Artion Hasani, anëtar


Neni 3

Për zbatimin e këtij Plani do të kujdeset drejtort komunal,zyrtari për transparenc Komunale dhe Kryetari i Komunës së Drenasit .

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Plani i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit;



Leonora Bajrami

From: Nazmije G.Krasniqi
Sent: Wednesday, March 1, 2023 1:55 PM
To: Leonora Bajrami
Cc: Gëzim Sahiti; Besim Murtezani; Flurim Arifi; Majlinda Shaqiri
Subject: FW: Per vlerwsim
Attachments: 3.Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Drenasit 2023-2027..pdf

E nderuar,

Divizioni për Transparencë Komunale, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2020 për Transparencën në Komuna, Rregulloren (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve komunale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe Ligjin Nr. 06/l-081 për qasje në dokumente publike, konstaton se:

Plani i Veprimit për Transparencë nga komuna e Glllogcit, është në pajtueshmëri me dispozitat ligjore për transparencë.

Me respekt
Nazmije Krasniqi
Udhëheqëse e Divizionit për Transparencë në Komuna/MAPL
Email: Nazmije.G.Krasniqi@rks-gov.net
Tel: 200 /35 558

From: Leonora Bajrami
Sent: Monday, February 27, 2023 10:07 AM
To: Nazmije G.Krasniqi <Nazmije.G.Krasniqi@rks-gov.net>
Cc: Gëzim Sahiti <Gzim.Sahiti@rks-gov.net>
Subject: Per vlerwsim

Përshëndetje,

JU lutem a mund te bëni vlerësimin e planit te veprimit për transparencë ne komunën e Glllogcit.



Republika e
Kosovës

Me respekt,

Leonora Bajrami
Zyrtare për Monitorim të Komunave
Qerveria e Republikës së Kosovës
Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal
Departamenti Ligjor dhe Monitorim i Komunave

PHONE

MOBILE

EMAIL

+383 49 500 312 leonora.bajrami@rks-gov.net

Adresa: Prishtinë, Ndërtesa e Qeverisë 'Ish Rilindja' Kati 11/1117